

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil si gjykatë e shkallës së parë, dhe atë gjyqtari Enes Mehmeti me sekretaren juridike Minire Krasniqi, në çështjen civile të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj të cilin e përfaqëson [REDACTED] në Gjilan përfaqësuesi ime autorizim [REDACTED] kundër të paditurës [REDACTED] nga Ferizaj, për borxh, pas seancës kryesore publike të mbajtur më 28.03.2017, në prezencë të përfaqësuesit të paditësit dhe përfaqësuesit të paditurës morri këtë:

### A K T G J Y K I M

**APROVOHET** në tërësi **SI E BAZUAR** kërkesë padia e paditësit, [REDACTED] Nëntori'' nga Ferizaj

**DETYROHET** e paditura [REDACTED] nga Ferizaj që paditësit t'ia kthejnë shumën e borxhit për qira prej 7373 euro si dhe tia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

Paditësi [REDACTED] nga Ferizaj të cilin e përfaqëson [REDACTED] në Gjilan- përfaqësuesi me autorizim [REDACTED], në padi dhe në seancat e shqyrtimit kryesor deklaron: se ngel në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që në tersi ta miratoj kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar, duke e obliguar të paditurën që në emër shfrytëzimit të lokalit afarist të paguaj shumën prej 8.655 euro për periudhën kohore prej 01.10.2014 e deri më dt.30.06.2006

I autorizuari i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se ngel pranë përgjigjes ne padi, pranohet pjesërisht padia e paditëses konform marrëdhënieve juridiko – civile të krijuara në kontratën menr.270 dt.17.07.2008 e cila është strikte e përcaktuar në shtyllën 4 të të njëjtës kontratë dhe vlefshmëria e saj është e përcaktuar i fillim i saj 07.06.2003 e deri më 07.09.2003 , që do të thotë se pranohet obligimi për tre muaj si në kontratën e theksuar, ndërsa pretendimet e paditësit se kjo kontrate mund të pranohet si vazhdim ne heshtje konform nenit 596 të LMD-së nuk mund të aplikohet në këtë rast meqë kjo ka të bëjë me kontratë të përcaktuar si në kohë dhe detyrime.

Gjykata në këtë çështje juridike civile, për të vërtetuar drejt gjendjen faktike në procedurën e provave sipas propozimit të përfaqësuesit të paditësit bëri administrimin e këtyre provave: lexohet kontrata mbi qiranë nr.270 dt.17.07.2003 e lidhur në mes ndërgjygiësve, fatura me nr.163/06 dt.26.05.2006 lëshuar nga paditësja, dëshmia e dëshmitarit [REDACTED] kontrata nr.269 ed t.17.07.2003 e lidhur në mes ndërgjygiësve.

Përfaqësuesi me autorizim i [REDAKTUAR] në Gjilan- [REDAKTUAR] deklaroi- nga administrimi i provave u vërtetuar se e paditura e ka shfrytëzuar lokalit afarist edhe pas përfundimit të afatit të kontraktuar e që konsiston në lidhjen e kontratës së re në heshtje në kuptim të nenit 596 të LMD-së, e deri në privatizimin e lokalit më dt.30.06.2006, sa i përket nënshtrimit të apo lidhjes së kontratës tjetër me të paditurën, pas skadimit të afatit kontestues nuk ka qenë e mundur për shkak se e paditura nuk i ka përgjigjur kërkesat e paditësit për lidhjen e një kontratë të re. Ajo është jokontestuese në rastin konkret është përgjegjur kërkesave të paditëses për lidhjen e një kontrate të re. Ajo që është jokontestuese në rastin konkret është se e paditura lokalit afarist e ka shfrytëzuar deri në datën e privatizimit të lokalit me dt.30.06.2006, andaj i propozoj gjykatës që ta aprovon në tersi si e bazuar kërkesa padia e paditësit dhe ta detyroj të paditurën që të paguaj në emër të borxhit të papaguar për shfrytëzimin e lokalit afarist për periudhën kohore 01.10.2004 deri më dt.30.06.2006 shumën prej 8.655 euro të gjitha në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. I ka kërkuar shpenzimet sa i përket taksave të procedurës gjyqësore.

I autorizuar i te paditurës av. [REDAKTUAR] ka deklaruar se në bazë të padisë dhe kërkesë padisë dhe provave të ushtruara nga kjo gjykatë u vërtetua se e paditura është palë kontraktuese konform kontratës nr.270 dt.17.07.2003 e cila nuk e konteston obligimin kontraktues për qera për 3 muaj në shumën prej 1296 euro. Ndërsa pretendimet e paditëses se e njëjta është vazhduar me kontratën nr.269 dt.17.07.2003 e paditura këtë kontratë nuk e ka parë, nuk e ka nënshkruar andaj edhe të njëjtën e kontestojmë në tersi në të gjitha kërkesat materiale që rrjedhin nga kjo. Pretendimet e paditëses se neni 596 i LMD-së mund të aplikohet edhe në këtë rast është i pabaze meqë e paditura nuk e ka shfrytëzuar asnjë ditë pas datës së përcaktuar në shtyllën 4 të kontratës nr.270 e cila është përkufizuar në kohë për fillimin dhe mbarimin e të njëjtit lokal. Prandaj kontrata e nënshkruar në mënyrë të njëanshme nga qiradhënësi pa pëlqimin e qiramarrësit dhe nënshkrimit të saj mund të prodhon efekt juridik e as material, prandaj i propozoj gjykatës që në këtë pjesë të padisë ta refuzon si të pabazuar. I ka kërkuar shpenzimet sipas tarifës së avokatëve.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar ashtu si që është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit nga këto arsye.

Gjykata gjeti se ekziston detyrimi i të paditurës për pagesën e borxhit në shumë prej 7373 euro në kuptim të neneve 413, dhe 414 të LMD-së për shkak se në bazë të provave të administruara u vërtetua se e paditura ka shfrytëzuar lokalit afarist për periudhën kohore prej 01.10.2004 deri më 30.06.2006, paditësja e ka përdorur lokalit afarist edhe për periudhën kohore kur nuk ka nënshkruar kontratë e kjo është vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili ka deklaruar se e paditura lokalit afarist e ka përdorur deri më dt.31.05.2007 gjer në privatizim si dhe ka prezantuar faturën 163/2006 të datës 26.05.2006 lëshuar në emër të të paditurës.

Gjykata vendimin e shpenzimeve procedurale e mbështet në kuptim të nenit 452 të LPK-së, dhe e detyroj të paditurën që të paguaj shpenzimi kontestimore dhe taksën për aktgjykim në shumën prej 50 euro të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Nga lartë të shënuarit është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMEORE NË FERIZAJ,  
C.nr.606/13, më 28.03.2017

Sekretare juridike  
Minire Krasniqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

